



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI I MINISTRAVE**

**V E N D I M**

**Nr. 691, datë 21.11.2018**

**PËR**

**PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR DISA SHTESA DHE  
NDRYSHIME NË LIGJIN NR.139/2015, “PËR VETËQEVERISJEN  
VENDORE”**

Në mbështetje të neneve 81, pika 1, e 100, të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

Propozimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, për shqyrtim e miratim në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, sipas tekstit e relacionit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**Kuvendi**

**PROJEKTLIGJ**

**Nr. \_\_\_\_\_/2018**

**PËR**

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.139/2015, “PËR  
VETËQEVERISJEN VENDORE”**

Në mbështetje të neneve 78 e 83, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,  
Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

**V E N D O S I:**

Në ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

**Neni 1**

Pas nenit 29 shtohet neni 29/1, me këtë përmbajtje:

**“Neni 29/1**

**Funksionet e bashkive në fushën e diasporës dhe të migracionit**

Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:

- a) Krijimin e strukturës së posaçme për diasporën dhe migracionin, për administrimin e shërbimeve në nivel vendor, si pjesë administrative e njësisë vendore;



- b) Nxitjen e organizimeve, brenda dhe jashtë vendit, për mbajtjen e komunikimit të vazhdueshëm e forcimin e marrëdhënieve me diasporën dhe migrantët shqiptarë;
- c) Dhënien e ndihmës e të informacionit për çështje që lidhen me regjistrimin e fitimin e shtetësisë;
- ç) Dhënien e ndihmës e informacionit për legjislacionin shqiptar në fuqi për të interesuarit nga diaspora dhe migracioni, në fushën e investimeve;
- d) Koordinimin e bashkërendimin e punës me ministritë përgjegjëse për punët e brendshme, për punët e jashtme dhe për diasporën, për garantimin e dhënies së ndihmës e informacionit për çështjet që lidhen me diasporën dhe migracionin.”.

### **Neni 2**

Në pikën 2, të nenit 12, pas fjalëve “... grupet e interesit ...” shtohen fjalët “... e përfaqësueseve të diasporës ...”.

### **Neni 3**

Në nenin 44, fjalët “... 31 mars ...” zëvendësohen me fjalët “... 31 maj ...”.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

**K R Y E T A R I**

**GRAMOZ RUÇI**